



## OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

### DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Drejtuar:** OE “Alstezo” sh.a., me NIPT J63208420N  
Adresa: Lagjja “Kryengritja e Fierit”, Fier

**Procedura e prokurimit:** E Hapur, mbi kufirin e larte monetar – me mjete elektronike – Sherbime, Marrëveshje Kuadër, me një operator ekonomik, ku të gjithë kushtet janë të përcaktuara.

**Numri i referencës së procedurës:** REF-30626-05-24-2022

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Riparime, shërbime, pjesë këmbimi për automjetet e OST sh.a., për një periudhë 2(dy) vjeçare”.

**Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):** Buletini i Njoftimeve Publike Data 30.05.2022, Nr. 69.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 (dy) Ofertues si më poshtë me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. OE “ALSTEZO” sh.a.** me NIPT J63208420N

Me shumatore të çmimeve për njesi 474,397,820 (katërqind e shtatëdhjetë e katër milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet) Lekë pa TVSH dhe vlerë totale 60,000,000 (gjashtëdhjetë milion) Lekë pa TVSH.

**2. OE “BUSHI SERVIS” sh.a.** me NIPT J61821054G

Me shumatore të çmimeve për njesi 475,931,440 (katërqind e shtatëdhjetë e pesë milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e dyzet) Lekë pa TVSH dhe vlerë totale 60,000,000 (gjashtëdhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi si më poshtë:

**1. OE “BUSHI SERVIS” sh.a., me NIPT J61821054G,** për arsye se:

- Nuk ka përmbushur kriterin 1/a, të Shtojcës 7, pika 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të DST, pasi nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9. Ky Formular shërben për plotësimin edhe të pikave 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.14, të Dokumenteve të Tenderit, të cilat rrjedhimisht nuk konsiderohen të plotësuara nga OE ofertues.
- Nuk ka përmbushur kriterin 1/b, të Shtojcës 7, pika 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të DST, pasi nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas kërkesës së nenit 83, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe sipas përcaktimit të pikës 3.1 të Njoftimit të Kontratës, në Dokumentet e Tenderit.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1, të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të DST, pasi nuk ka paraqitur vërtetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për tre vitet e fundit financiare dhe kopje të certifikuara të bilanceve.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.1, të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të DST, pasi nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme në vlerën e kërkuar në Dokumentet e Tenderit.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.6, të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të DST, pasi nuk ka vërtetuar se disponon, në pronësi ose me qira, ambiente për ushtrimin e aktivitetit të tij në rrethet ku Autoriteti Kontraktor ka Njesitë Operative (Tiranë, Shkodër, Burrel, Korçë, Fier, Elbasan).
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.7, të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të DST, pasi nuk ka paraqitur autorizimin e prodhuesit/ve ose distributorëve të autorizuar me të cilët bashkëpunon, kërkuar për artikujt/mallrat objekt prokurimi.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.8, të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të DST, pasi nuk ka paraqitur Certifikatën ISO 45001: Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.9, të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të DST, pasi nuk ka plotësuar dhe paraqitur tabelën e përcaktuar në këtë pikë, duke mos specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet e lëshuara nga një organ i akredituar.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.11, të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të DST, pasi nuk ka paraqitur katalogun e prodhuesit / prodhuesve si dhe skemat origjinale të montimit për pjesët e këmbimit që do të montohen gjatë riparimit.
- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.13, të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të DST, pasi ka paraqitur tabelën e ofertës, ku të përcaktohet emri i kompanisë prodhuese, emërtimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. i faqes së këtij katalogu si dhe kodi original i pjesëve të këmbimit që do të montohen gjatë riparimit të mjetit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “ALSTEZO” sh.a. me NIPT J63208420N**, Adresa: Lagjja “Kryengritja e Fierit”, Fier, se oferta e paraqitur me shumatore të çmimeve për njesi 474,397,820 (katërqind e shtatëdhjetë e katër milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet) Lekë pa TVSH dhe vlerë totale 60,000,000 (gjashtëdhjetë milion) Lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.

**ADMINISTRATORI I OST SH.A.**

**Skerdi Drenova**